



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:178777
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06229111

K.DH.SH.II.nr.1032/24

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbareme të kreditorit NPSH “N...” me adresë në fshatin ..., Komuna e Suharekës me NUI: ..., të cilin me autorizim e përfaqëson G.K. avokat nga Suhareka, ndaj debitorit “I.F...Shpk me adresë në Istog me NUI: ..., duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Përmbareme KPPP.nr.1538/23 të datës 28.02.2024, me datë 20.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit “NPSH “N...” me adresë në fshatin ..., Komuna e Suharekës, e datës 20.03.2024, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Përmbareme KPPP.nr.1538/23 të datës 28.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Përmbareme KPPP.nr.1538/23 të datës 28.02.2024, e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “I...F...” Shpk, dhe ka shfuqizuar Urdhin P.nr.355/2022 të datës 21.07.2022 i lëshuar nga Përmbaremi Privat Enis Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike- neni 183 dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale- neni 184, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të tërësishëm dhe të mirëfillshëm të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të aprovon ankesën e kreditorit N.P.Sh “N...” me seli në fshatin ... Komuna e Suharekës me NUI: ... në tërësi si të bazuar të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1538/23 të datës 28.02.2024 ashtu që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “L...F...” ShPK, me seli në Istog me NUI: ... dhe mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr.355/2022 i datës 21.07.2022 i lëshuar nga përmbaruesi privat Enis Hoxha nga Prizreni, të detyrohet debitori “L...F...” Shpk me seli në Istog me NUI: ... që kreditorit NPSH “N...” me seli në fshatin ... Komuna e Suharekës që të ia paguaj borxhin në shumën prej 2,402.40€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesdë e deri në përmbushjen definitive si dhe shpenzimet përmbarimore për lejim të përmbarimit për përgjigje në prapësim në shumë prej 208.00€ dhe për këtë ankesë dhe taksën shumë prej 135.00€ apo të priset aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1538/23 i datës 28.02.2024 dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimore dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit me datën 21.07.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.184/2021 të datës 16.10.2021. Përmbaruesi privat Enis Hoxha, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.355/2022 të datës 21.07.2022, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t’i paguaj shumën prej 2,402.40euro, me kamatë prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive, si dhe të gjitha

shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 10.08.2022, me pretendimin se e kundërshton në tërësi propozimin për përbarim pasi që i njëjti nuk përmban titull ekzekutiv dhe nuk është i përshtatshëm për ekzekutim në kuptim të nenit 71.1.1 të LPP-së. Më tej ka theksuar se nuk mund të trajtohet si titull përbarimor fatura e cila asnjëherë në asnjë rast nuk i është dorëzuar debitorit. Madje në rastin konkret nuk ka askund vulë të firmës “I...F...” pra debitorit e as nënshkrimi i konstatuar në faturë nuk është nënshkrimi personit përgjegjës të debitorit. Në kuptim të lartcekurave i propozojmë gjykatës që të mbajë seancë në mënyrë që të sqarohen detaje lidhur me pretenimet e palëve e që propozojmë të kryhet edhe ekspertizë grafologjike lidhur me nënshkrimet e konstatuara në faturat e kreditorit për debitorin, të cilat asnjëherë në asnjë rast debitorit nuk i janë dorëzuar dhe nuk i ka pranuar, madje as me vulë të firmës “I...F...” e që e ka të domosdoshme në fatura të jenë vulat përkatëse të palëve e që në rastin konkret mungon vula e debitorit që dmth se kjo faturë nuk është dorëzuar asnjëherë debitorit nga ana e kreditorit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 16.08.2022 duke kundërshtuar urdhërin përbarimor dhe atë për shkak të shkeleje esenciale të dispozitave të LPP-së, konsiderojmë dhe besojmë bindshëm që urdhëri përbarimor i kreditorit është i bazuar në fakte dhe prova konkrete gjë që vërtetojnë dhe provojnë bazën dhe themelsinë juridike të urdhërit përbarimor, andaj propozojmë që gjykata kompetente në këtë çështje përbarimore në kuptim të nenit 27 par.1 29 par.1, pika 1.3, 72, 73 të LPP-së, jashtë seancës gjyqësore të vendos ashtu që të refuzoj prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar.

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit ka vendosur që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.355/2022 të datës 21.07.2022, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Gjykata ka konstatuar se në ratin konkret, në propozimin për përbarim nuk janë treguar dokumentet e besueshme-fatura nr. 182/2021 e datës 13.10.2021, fatura 191 e datës 22.10.2021 të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ndërsa fatura nr. 184/2021 e datës 16.10.2021 në bazë të së cilës është lejuar përbarimi, rezulton se shuma e

kësaj fature në vlerë prej 1,008.00€ është më e ulët sesa shuma e kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbaerim dhe e lejuar me urdhër nga Përmbaeruesi Privat e cila shumë është në vlerë prej 2,402.40€ Dhoma e Shkallës së Parë në aktvendimin e saj ka arsyetuar se nuk i plotëson kriteret e dokumentit të besueshëm siç parasheh neni 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 3 të LPP-së në të cilin parashihet “*Dokument i besueshëm është i përshatshëm për përmbaerim po që së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Andaj gjykata ka vlerësuar se fatura nr.184/2021 e datës 16.10.2021 në bazë të së cilës është lejuar përmbaerimi nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbaerimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykes Komerciale nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Dhomës së Shkallës së Parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë ne shkelje thelbesore te dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 pikat, b), g), j), k) dhe m) te LPK dhe nuk ka zbatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike ndërsa ka zbatuar drejt dispozitat materiale per çka edhe Doma e Shkalles se Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 te LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar pasi e njëjta ka analizuar saktë gjendjen faktike. Shiqur në shkresat e lëndës shihet qartë se Fatura me nr.184/2021 te datës 16.10.2021, mbi bazën e se cilës është propozuar përmbaerimi, nuk i plotëson arsyet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm, sepse e njëjta nuk përmban të gjitha elementet që kërkohen me dispozitat ligjore përkatësisht neni 29 par 1 të LPP-së ku parashihet se “*Përmbaerimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*” ndërsa me nenin 29 par 3 të të njëjtit ligj parashihet se: “*Dokument i besueshëm është i përshatshëm për përmbaerim po që së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e që në rastin konkret urdhëri përmbaerues është lëshuar mbi faturën me numër 184/2021 e datës 16.10.2021 dhe atë në shumë prej 1,008.00euro e cila shumë është më e vogël se shuma me të cilën është lëshuar urdhëri përmbaerimorë në vlerë prej 2,402.40 euro, andaj në propozim për lejimin e përmbaerimit nuk figurojnë faturat nr.182/2021 e datës 13.10.2021 e as fatura me nr.191 e datës 22.10.2021 të cilat janë bashkangjitur në shkresat të lëndës, kështu sipas dispozitës së lartë dhe urdhërit të lejuar nuk përmbanë shumën e sakt, andaj të metat e propozimit për përmbaerim nuk mund të evitohen nga gjykata, sepse në fazën e mjetit juridik gjykata kufizohet

vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhëri si dhe ligjshmërinë e urdhërit .

Kjo gjykatë ka analizuar edhe pretendimet tjera të kreditorit por i vlerësoj se nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore.

Kompetenca e Gjykares Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispoziten e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-DHOMA E SHKALLES SE DYTË

K.DH.SH.II nr.1032/24, me datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2022:178777
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06229111